



**Republika e Kosovës/
Republika Kosova / Republic of Kosovo**
Fondi i Sigurimit Shëndetësor / Fond za Zdravstveno Osiguranje /
Health Insurance Fund

RAPORT TREMUJOR I PUNËS PËR PERIUDHËN JANAR – MARS 2019

Prishtinë, prill 2019

Tabela e përmbajtjes

Fjala hyrëse e Drejtorit të Fondit	3
1 Hyrje	5
2 Realizimi i Buxhetit për periudhën tremujore TM1/2019	6
3 Programi i trajtimeve mjekësore jashtë ISHP-ve	9
4 Objektivat dhe realizimi i tyre për periudhën tremujore	12
5 Shtojca - Objektivat dhe aktivitetet e realizuara në TM1 – 2019	20

Fjala hyrëse e Drejtorit të Fondit

I nderuar Kryesues, të nderuar anëtarë të Bordit Drejtues,

Kam kënaqësinë të paraqes para jush Raportin e Përformancës për Fondin e Sigurimeve Shëndetësore për periudhën tremujore (janar – mars 2019).

Ky raport ofron informata mbi aktivitetet e zhvilluara nga institucioni jonë, si janë shfrytëzuar burimet e besuara për këtë periudhë, si dhe njëkohësisht tregon hapat që do të ndërmerren në të ardhmen për të adresuar sfidat e hasura.

Zhvillimet në Fond brenda kësaj periudhe raportuese, tregojnë hapa të rëndësishëm drejtë realizimit të misionit tonë drejtë funksionalizimit të Fondit, përkatësisht krijimit të një institucioni kredibil, i cili siguron qasjen universale të qytetarëve të Kosovës ndaj shërbimeve kualitative të kujdesit shëndetësor.

Plani i Punës për vitin 2019 ka paraparë 14 objektiva strategjike, 51 aktivitete dhe 170 nën-aktivitete. Prej tyre vetëm në tremujorin e parë të këtij viti janë paraparë 88 nën-aktivitete, ose afro 52% e planit vjetor, megjithëse në tremujoret tjerë janë disa objektiva specifike të cilat marrin më shumë kohë.

Megjithëse, plani vjetor për vitin 2019 është aprovuar më vonesë prej afro 1.5 muaj, unë jam i kënaqur të raportoj një përqindje të kënaqshme të realizimit të objektivave (nën-aktiviteteve), përfshirë edhe ato në proces brenda periudhës tremujore të këtij viti, në 82%.

Duke pasur parasysh rëndësinë e realizimit të këtij plani, ne brenda institucionit kemi krijuar një kulturë të orientuar drejt rezultateve. Me tutje, ne kemi instaluar një mekanizëm i cili monitoron dhe mbikëqyr ngushtë zbatimin e tij, si dhe për secilin tremujor ne do të raportojmë para jush për të prezantuar sukseset e arritura brenda periudhës raportuese, ngecjet aktuale, si dhe sfidat që mund të na presin në të ardhmen e afërt.

Gjatë periudhës raportuese ne kemi siguruar një qeverisje efektive, kemi siguruar transparencë dhe llogaridhënie në të gjitha proceset. Gjithashtu kemi realizuar të gjitha objektivat strategjike lidhur me identifikimin e nevojave për plotësim/ndryshimin e akteve ligjore dhe nënligjore si dhe kemi realizuar të gjitha nën-aktivitetet e përcaktuara për zhvillimin dhe zbatimin e Sistemit të Informimit të Fondit.

Përmes konsulentëve të jashtëm kemi siguruar një draft analizë për financimin e sektorit të shëndetësisë e cila paraqet një analizë të të hyrave dhe shpenzimeve të Fondit për një periudhë tri vjeçare. Megjithëse, kjo analizë do të zgjerohet edhe me tutje duke përfshirë në detaje edhe metodologjinë e funksionimit të proceseve rreth grumbullimit të të hyrave dhe mbulimit të shpenzimeve, dokument i cili do të dorëzohet si final në fund të muajit maj të këtij viti.

Gjithashtu gjatë kësaj periudhe kemi përmirësuar dukshëm proceset e trajtimeve mjekësore jashtë Institucioneve Publike Shëndetësore, kemi rritur bashkëpunimin me institucionet vendore dhe me partneret ndërkombëtar si dhe kemi marrë të gjitha veprimet e planifikuara për sigurimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të Fondit për Sigurime Shëndetësore.

Me gjithë të arriturat e potencuara më lartë ne kemi pasur edhe disa sfida në realizimin e objektivave përfshirë plotësimin e parakushteve për kontraktim të shërbimeve si dhe fillimin e mbledhjes së premieeve, si dhe komunikimit me publikun qoftë përmes kampanjave informuese ose formave tjera më qëllim të rritjes së besimit nga ana e publikut. Megjithatë, gjatë periudhës prill – qershor 2019/TM-2 ne do të angazhohemi që përpos nën-aktiviteteve të parapara për këtë periudhë (TM-2) t'i realizojmë edhe të gjitha nën-aktivitetet e mbetura nga TM-1.

Ne jemi të përkushtuar që sa më shpejtë të jetë e mundur, Fondi i Sigurimeve Shëndetësore të jetë në funksion të plotë dhe të ofrojmë shërbime shëndetësore cilësore dhe mburojë financiare për të gjithë qytetarët e vendit.

Ne vijim paraqesim raportin me informata më të detajuara për rezultatet e arritura në kuadër të tremujorit të parë të këtij viti në raport me objektivat, aktivitetet dhe nën-aktivitetet e përcaktuara në planin vjetor të punës për vitin 2019.

Me respekt,

Fatmir Plakiqi 

Drejtor i Fondit të Sigurimeve Shëndetësore

Prishtinë, prill 2019

1 Hyrje

Bordi Drejtues i Fondit për Sigurime Shëndetësore (me tutje Fondi) ka miratuar Planin e Punës për vitin 2019 me datën 13 shkurt 2019, i cili në mënyrë të strukturuar paraqet të gjitha objektivat dhe aktivitetet e përcaktuara për plotësimin e të gjitha parakushteve për funksionalizimin e plotë të Fondit i përcaktuar me Ligjin 04L/249 për Sigurimin Shëndetësor.

Planifikimi i aktiviteteve është bërë duke marrë parasysh të gjitha burimet me të cilat disponon Fondi i Sigurimeve Shëndetësore, përfshirë burimet njerëzore dhe ato financiare.

Megjithatë, disa nga aktivitetet e planifikuara janë prolonguar për shkak të vonesave në përcaktimin e bazës ligjore (plotësim/ndryshimin e Ligjit të Sigurimeve Shëndetësore), ose për shkak të mungesës stafit.

Realizimi i këtij plani do të kontribuojë në realizimin e qëllimit kryesor të funksionit të Fondit, "Sigurimi i qasjes universale të qytetarëve dhe banorëve të Republikës së Kosovës ndaj shërbimeve kualitative të kujdesit themelor shëndetësor, me qëllim të përmirësimit të indikatorëve shëndetësor dhe sigurimit të mbrojtjes financiare nga varfërimi për shkak të shpenzimeve të mëdha për kujdesin shëndetësor nëpërmjet themelimit dhe rregullimit të sistemit publik të sigurimit shëndetësor".

Duke pasur parasysh rëndësinë e realizimit të këtij plani Drejtori i Fondit ka instaluar një mekanizëm i cili monitoron dhe mbikëqyr ngushtë zbatimin dhe realizimin e tij, si dhe raporton në baza tremujore para Bordit Drejtues për të prezantuar sukseset në realizimin e planit si dhe ngecjet aktuale dhe sfidat që mund të na presin në të ardhmen e afërt.

Plani i Punës për vitin 2019 ka paraparë 14 objektiva strategjike, 51 aktivitete dhe 170 nën-aktivitete. Prej tyre 88 aktivitete janë planifikuar në tremujorin e parë TM-1.

2 Realizimi i Buxhetit për periudhën tremujore TM1/2019

2.1. Buxheti

Bazuar në Ligjin Nr. 06/L -133 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019, Fondit i janë ndarë 8,697,583€.

Tabela 1. Buxheti i ndarë për Fondin për vitin 2019

Shpenzimet/ Departamentet	Administrata	Trajtimi Jashtë Institucioneve Publike Shëndetësore	Gjithsej buxheti për vitin 2019
Pagat dhe mëditjet	641,286		641,286
Mallrat dhe Shërbimet	1,060,137		1,060,137
Shpenzimet komunale	66,160		66,160
Subvencionet dhe transferet		6,000,000	6,000,000
Shpenzimet kapitale	930,000		930,000
Gjithsej buxheti për vitin 2019	2,497,586	6,000,000	8,697,583

Nga tabela nr.1 mund të shohim se nga gjithsej buxheti i ndarë për vitin 2019 në vlerë 8,697,583€, vlera prej 6,000,000€ ose 69% e totalit të buxhetit janë ndarë për trajtime mjekësore jashtë Institucioneve Publike Shëndetësore, ndërsa pjesa tjetër për shërbimet administrative të Fondit.

Buxheti i ndarë për vitin 2019 trajtime mjekësore jashtë Institucioneve Publike Shëndetësore në 6 mil€ nuk mbulon as obligimet e mbetura në fund të vitit 2018 për këtë program, të cilat ishin 7,170,229€. Kjo paraqet sfidë për Fondit sepse për çdo vit kalendarik aplikojnë për trajtime jashtë Institucioneve Publike Shëndetësore rreth 1,500 pacientë dhe mesatarja e shpenzimeve vjetore është afro 12 mil€. Andaj obligimet e mbetura janë duke u rritur nga viti në vit.

2.2. Shpenzimet


Tabela 2. Shpenzimet në raport me buxhetin për vitin 2019 si dhe buxhetin e alokuar për TM-1

Kodi i programit	Programet	Buxheti sipas ligjit	Buxheti i alokuar (TM-1)	Shpenzimet për TM-1 2019	Shpenzimi i Buxhetit në %
11324	Paga dhe rroga	641,286	83,849	83,849	13.08%
	Mallra dhe shërbime	1,060,137	132,041	66,357	6.26%
	Shpenzime komunali	66,160	16,660	11,339	17.14%
	Shpenzime kapitale	930,000	30,000	-	
71600	Transfere dhe Subvencione	6,000,000	1,800,000	1,510,028	25.17%
Gjithsej		8,697,583	2,062,550	1,676,707	19.22%

Nga tabela më lartë mund të shohim se nga gjithsej buxheti i ndarë për vitin 2019 në vlerë 8,697,583€, në tremujorin e parë TM-1 janë shpenzuar 1,676,707€ ose 19.22%. Shpenzimet janë bërë në pajtueshmëri të plotë me rregullat e Thesarit, duke filluar nga kontraktimi e deri te ekzekutimi i tyre.

Në figurën në vijim mund të vërehen shpenzimet në raport me buxhetin për vitin 2019 si dhe buxhetin e alokuar për periudhën tremujore TM-1.

Figura 1. Shpenzimet në raport me buxhetin për vitin 2019 si dhe buxhetin e alokuar për TM-1



2.3. Obligimet

Fondi ka krijuar një sistem të mirë të pagesave në pajtueshmëri të plotë me rregullat e Thesarit, duke filluar nga kontraktimi e deri te ekzekutimi i tyre. Secila faturë e pranuar fillimisht protokollohet dhe paguhet brenda afateve të përcaktuara ligjore. Për të gjitha faturat e pa paguara mbahet një evidencë e veçantë të cilat janë raportuar rregullisht në Ministrinë e Financave.

Përkundër këtij procesi të rregullt të pagesave, një shumë e konsiderueshme e obligimeve kanë mbetur të papaguara. Me 31 mars 2019 ato ishin në vlerë 9,416,522€, ose për 1,913,090€ më të larta në krahasim me fund-vitin 2018 (në fund të vitit 2018 obligimet e Fondit ishin 7,503,432€).

Tabela 3. Obligimet më 31 mars 2019

Kategoria Ekonomike	Obligimet me 31 dhjetor 2018	Obligimet me 31 mars 2019	Obligimet me 31 mars 2019 në %
Mallra dhe Shërbime	56,854	669	0.01 %
Shpenzime Komunali	4,355	-	-
Subvencione dhe Transfere	7,170,229	9,415,853	99.99 %
Investime Kapitale	271,994	-	-
Gjithsej	7,503,432	9,416,522	100%

Përpos obligimeve të cilat janë të raportuara në Ministrinë e Financave, Fondi ka edhe disa detyrime kontingjente.

Gjatë periudhës tremujore TM-1 2019, ndaj Fondit ishin bërë 12 ankesa, nga të cilat 11 janë shqyrtuar nga komisioni për ankesa. Nga gjithsej ankesat e shqyrtuara katër (4) janë aprovuar dhe shtatë (7) janë refuzuar. Pas këtij procesi disa prej tyre kanë bërë padi nga Fondit dhe këto raste pritet të trajtohen në të ardhmen.

Përpos detyrimeve kontingjente të cilat janë shpalosur në raportin vjetor të vitit 2018, gjatë periudhës tremujore janë bërë edhe katër (4) padi të reja në vlerë totale 32,852€. të cilat janë shpalosur në tabelën në vijim.

Tabela 4. Detyrimet kontingjente të periudhës janar – mars 2019

Paditësi	i Padituri	Përshkrimi	Vlera
D.M.	Fondi i Sigurimeve Shëndetësore	Kompensim për trajtim jashtë vendit	8,400€
S.M.	Fondi i Sigurimeve Shëndetësore	Kompensim për trajtim jashtë vendit	1,400€
A.O.	Fondi i Sigurimeve Shëndetësore	Kompensim për trajtim jashtë vendit	13,560€
H.O.	Fondi i Sigurimeve Shëndetësore	Kompensim për trajtim jashtë vendit	9,492€
Gjithsej			32,852€

2.4. Pasuritë

Në fund të vitit 2018 është krijuar komisioni për inventarizim të pasurisë i cili pas procesit të identifikimit/numërimit fizik të pasurisë ka hartuar raportin i cili është krahasuar me raportet e pasurisë për të identifikuar dhe eliminuar diferencat.

Me pas, pas aprovimit të ligjit të buxhetit ku Fondi është ndarë si organizatë buxhetore e veçantë është krijuar një komision për transferimin e pasurisë nga Ministria e Shëndetësisë të Fondi i Sigurimeve Shëndetësore, proces i cili ka përfunduar në tremujorin e parë të këtij viti.

3 Programi i trajtimeve mjekësore jashtë ISHP-ve

Programi për trajtim mjekësor jashtë institucioneve shëndetësore publike (TMJISHP) është program i themeluar me qëllim të ofrimit të shërbimeve shëndetësore në kushtet kur institucionet shëndetësore publike nuk mund të ofrojnë shërbime të tilla. Këto shërbime kryhen në institucione shëndetësore private brenda ose jashtë vendit. Funksionimi i këtij programi është i rregulluar me udhëzim administrativ në të cilin janë të parapara procedurat e përfitimit nga ky program si dhe organet për administrimin e programit.

Gjatë periudhës tremujore janar-mars 2019 kanë aplikuar 344 paciente për TMJISHP. Prej tyre janë aprovuar 214, ndërsa rastet tjera kanë mbetur të aprovohen ose për disa raste është kërkuar të kompletojnë dokumentacionin për TMJISHP-ve.

Tabela 5. Kërkesat dhe lendet e shqyrtuara për periudhën janar-mars 2019

Nr.	Përshkrimi	Janar - mars 2019
1	Aplikime	344
2	Raste urgjente	147
3	Raste të rregullta	197
4	Aprovime	214

Tabela 6. Aplikimet për trajtime mjekësore të referuara sipas klinikave për periudhën janar-mars 2019

Nr.	Klinika	Nr. i aplikimeve	Shuma
1	Oftalmologji	110	224,315
2	Pediatri	47	1,377,929
3	Ortopedi	32	359,150
4	Onkologji	18	34,781
5	Hematologji	17	125,430
6	Kardiologji	15	31,660
7	Kirurgji torakale	14	115,630
8	ORL	12	150,850
9	Kirurgji abdominale	10	99,199
10	Mjekësi nukleare	9	4,615
11	Neurologji	8	53,884
12	Nefrologji	8	85,390
13	Kirurgji vaskulare	8	127,803
14	Gastroenterologji	8	37,360
15	Nenonatologji	7	86,000
16	Urologji	7	21,273
17	Te tjera	14	97,911
Gjithsej		344	3,033,181

Figura 2. Aplikimet për trajtime mjekësore të referuara sipas klinikave për periudhën janar-mars 2019




Tabela 7. Pagesat për trajtimet mjekësore jashtë Institucioneve Publike Shëndetësore për periudhën janar – mars 2019


Nr.	Vendi	Rastet e trajtuara	Vlera	Mesatarja e shpenzimeve sipas rasteve	% e shpenzimit sipas vendeve
1	Turqia	37	950,771	25,697	62.96%
2	Kosovë	48	169,131	3,524	11.20%
3	Gjermania	8	81,737	10,217	5.41%
4	Italia	5	81,567	16,313	5.40%
5	Maqedonia	19	76,840	4,044	5.09%
6	Shqipëria	11	73,986	6,726	4.90%
7	Austria	3	44,145	14,715	2.92%
8	Belgjikë	1	14,015	14,015	0.93%
9	Anglia	1	12,097	12,097	0.80%
10	Slloveni	1	3,500	3,500	0.23%
11	Kroacia	1	2,240	2,240	0.15%
Gjithsej		135	1,510,028	10,281	100%

Nga tabela më lartë shohim se për periudhën tremujore të këtij viti janë kryer pagesat për 135 pacientë, me mesataren e shpenzimit prej 10,281€. Shpenzimet më të larta ose afro 2/3 janë bërë në Turqi, ndërsa numri më i lartë i rasteve të trajtuara mjekësore mbetet në spitalet private brenda vendit.

Pjesa më e madhe e pagesave janë bërë për të mbuluar obligimet nga vitet paraprake me përjashtim të disa rasteve kur kanë qenë urgjente si dhe spitalet nuk i kanë ofruar shërbimet shëndetësore para pagesës.

Në vijim pagesat për trajtime mjekësore për periudhën janar-mars 2019 janë prezantuar edhe në formë grafike.

Figura 3. Pagesat për trajtimet mjekësore jashtë Institucioneve Publike Shëndetësore për periudhën janar – mars 2019



4 Objektivat dhe realizimi i tyre për periudhën tremujore

Plani i Punës për vitin 2019 ka paraparë 14 objektiva strategjike, 51 aktivitete dhe 170 nën-aktivitete. Prej tyre 88 aktivitete janë planifikuar në tremujorin e parë TM-1. Prej tyre janë realizuar 72, ose 82%. Në vijim shpalosim në detaje rezultatet e arritura në raport me objektivat e përcaktuara.

Objektiva 1 - Sigurimi i një qeverisje efektive, transparencë dhe llogaridhënia në Fond

Në kuadër të kësaj objektive janë paraparë një sërë aktivitete që synojnë që Fondi të udhëhiqet mbi bazat e një qeverisjeje efikase, transparente dhe llogaridhëse.

Në kuadër të këtij objektivi janë paraparë shumë aktivitete që synojnë efikasitet institucional duke përfshirë identifikimin e risqeve si një prej parakushteve për një funksionalizim të qëndrueshëm institucional, mandej raporte e rregullta të auditimit të brendshëm, raportimet e rregullta mujore mbi gjendjen financiare si dhe raporti vjetor i Fondit i cili do të pasqyrojë gjitha aktivitetet duke siguruar transparencën e plotë. Këto aktivitete janë:

- 1.1 Përgatitja e një regjistri të rreziqeve të mundshme si dhe menaxhimi i efektiv i tyre;
- 1.2 Menaxhimi efikas i buxhetit në përputhje me ndarjet buxhetore për vitin 2019;
- 1.3 Auditimet dhe zbatimi i rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm dhe i jashtëm;
- 1.4 Menaxhimi efikas dhe raportimi i drejtë dhe i saktë i obligimeve të papaguara;
- 1.5 Menaxhimi efikas dhe raportimi i drejtë dhe i saktë i pasurisë jo-financiare;
- 1.6 Hartimi i Pasqyrave Financiare Vjetore; dhe
- 1.7 Raporti Vjetor për vitin 2018.

Për periudhën tremujore (TM-1) ky objektiv kishte gjithsej 22 nën-aktivitete, nga të cilat 18 janë realizuar, ndërsa katër (4) janë në proces të realizimit të vazhdueshëm.

Megjithatë disa nga aktivitetet kanë të bëjnë me raportimin e rregullt mujor dhe ato aktivitete do të vazhdojnë edhe në periudhat tjera tremujore.

Objektiva 2 - Përgatitja e planit strategjik pesë (5) vjeçar dhe planit vjetor të punës për vitin 2020

Një ndër objektivat më me rëndësi është edhe Planifikimi Strategjik i cili përbëj një segment të veçantë sepse siguron që institucioni ka vizionin dhe orientimet e tija kundrejt qëllimeve të matshme. Si i tillë, planifikimi strategjik është një mjet që është i dobishëm që shërben si udhërrëfyes për vendimmarrje të përditshme dhe gjithashtu për vlerësimin e progresit.

Në kuadër të këtij objektivi janë paraparë dy (2) aktivitete të ndërlidhura, si:

- 2.1 Përgatitja e planit strategjik pesë (5) vjeçar duke përfshirë vizionin, misionin, vlerat dhe qëllimet strategjike; dhe
- 2.2 Përgatitja e planit vjetor të punës për vitin 2020.

Ky objektivi në kuadër të TM-1 ka pasur gjithsej dy (2) nën-aktivitete, të cilat janë në proces të përfundimit.

Objektiva 3 - Identifikimi i nevojave për plotësim / ndryshimin e akteve ligjore dhe nënligjore si dhe procedurave të brendshme administrative si dhe inicimi i tyre për kompletimin e legjislacionit

Në kuadër të këtij objektivi janë gjithsej katër (4) aktivitete si në vijim:

- 3.1 Dhënia e kontributit në plotësim/ndryshim të Legjislacionit ekzistues;
- 3.2 Nxjerrja e rregulloreve të reja të cilat janë të nevojshme për plotësimin e legjislacionit sekondar të Fondit;
- 3.3 Krijimi i procedurave të brendshme administrative, përfshirë doracakët për udhëzimin e të punësuarve për punë; dhe
- 3.4 Përgatitjet për marrëveshje bilaterale me shtetet tjera.

Ky objektivi në kuadër të TM1 ka pasur gjithsej shtatë (7) nën-aktivitete, nga të cilat katër (4) janë përfunduar dhe tri (3) janë në proces të realizimit.

Objektiva 4 - Zhvillimi dhe implementimi i sistemeve

Në kuadër të këtij objektivi janë gjithsej katër (4) aktivitete si në vijim:

- 4.1 Ndërlidhja e sistemeve SISH- Sistemi i Informimit të Fondit;
- 4.2 Instalimi dhe konfigurimi i pajisjeve harduerike;
- 4.3 Menaxhimi, përditësimi, mirëmbajtja dhe migrimi i serverëve dhe pajisjeve të tjera; dhe
- 4.4 Planifikimi, zhvillimi dhe mirëmbajtja e sistemeve të brendshme të Fondit.

Ky objektivi në kuadër të TM1 ka pasur gjithsej 18 nën-aktivitete, nga të cilat 11 janë përfunduar plotësisht, ndërsa shtatë (7) janë në proces të përfundimit.

Objektiva 5 - Implementimi i Sistemit të Informimit të Fondit

Në kuadër të këtij objektivi janë gjithsej shtatë (7) aktivitete si në vijim:

- 5.1 Kontraktimi i Sistemit të Informimit të Fondit;
- 5.2 Implementimi i E-recetës;
- 5.3 Doracaku i përdorimit të e-recetës dhe trajnimi i shfrytëzuesve të E-recetës;
- 5.4 Implementimi i SIF-it (Moduli i ndërlidhjes me Agjencinë e Regjistrimit Civil (ARC), Bankën Qendrore të Kosovës (BQK), Administratën tatimore të Kosovës (ATK), si dhe institucionet tjera relevante;
- 5.5 Implementimi i SIF-it (Moduli për menaxhim të financave dhe kontabilitet);
- 5.6 Implementimi i SIF-it (Moduli i raportimit); dhe
- 5.7 Doracaku i përdorimit të SIF-it dhe trajnimi i shfrytëzuesve të SIF-it.

Ky objektivi në kuadër të TM1 ka pasur gjithsej katër (4) nën-aktivitete, tri (3) nga të cilat janë përfunduar, një (1) është në proces të përfundimit, ndërsa një (1) ka mbetur e pa përfunduar. Nën-aktiviteti i cili nuk është përfunduar ka të bëjë me Implementimin e SIF-it (Moduli i ndërlidhjes me Agjencinë e Regjistrimit Civil (ARC), Bankën Qendrore të Kosovës (BQK), Administratën tatimore të Kosovës (ATK), si dhe institucionet tjera relevante.

Objektiva 6 - Bashkëpunimi me Shërbimin Spitalor Klinik Universitar të Kosovës (SHSKUK) (KPSH) dhe Institucionet tjera të kujdesit shëndetësor. Parapërgatitja për kontraktimin e shërbimeve shëndetësore

Në kuadër të këtij objektivi është vetëm një (1) aktivitet që ka të bëjë me finalizimin e procedurave për kontraktim dhe definimi modelit të kontratës për shërbime shëndetësore.

Në kuadër të TM1 ky objektivi/aktivitet ka pasur një (1) nën-aktivitet, i cili është në proces të realizimit.

Objektiva 7 - Propozimi i Skemës së Financimit të Sektorit të Shëndetësisë

Në kuadër të këtij objektivi janë gjithsej dy (2) aktivitete si në vijim:

- 7.1 Analiza e financimit të sektorit të shëndetësisë; dhe
- 7.2 Finalizimi i Plan-Propozimit të Skemës së Financimit të Sektorit të Shëndetësisë.

Në kuadër të TM1 ky objektivi ka pasur shtatë (7) nën-aktivitete, nga të cilat tri (3) janë realizuar, kurse (4) nën-aktivitete nuk janë realizuar. Mos realizimi i tyre ka të bëjë me vonesat në plotësim/ndryshimin e ligjit të Fondit të Sigurimeve Shëndetësore.

Objektiva 8 - Menaxhimi efikas i trajtimeve mjekësore jashtë Institucioneve Publike Shëndetësore

Në kuadër të këtij objektivi janë gjithsej dy (7) aktivitete si në vijim:

- 8.1 Analiza e proceseve të trajtimit mjekësore jashtë Institucioneve Publike Shëndetësore; dhe
- 8.2 Barazimi me institucionet shëndetësore private.

Në kuadër të TM1 ky objektiv ka pasur katër (4) nën-aktivitete, nga të cilat dy (2) janë realizuar dhe dy (2) janë në proces të realizimit.

Objektiva 9 - Ngritja e bashkëpunimit me Institucionet tjera vendore si dhe me partneret ndërkombëtar

Në kuadër të këtij objektivi janë gjithsej pesë (5) aktivitete si në vijim:

- 9.1 Lidhja e marrëveshjeve të mirëkuptimit me ATK-në, ARC-në dhe me BQK-në;
- 9.2 Bashkëpunimi me Odat e profesionistëve shëndetësorë;
- 9.3 Lidhja e marrëveshjeve të mirëkuptimit me Institucionet e njëjta të vendeve të rajonit për shkëmbimin e përvojave;
- 9.4 Partnershipi me njërin nga Fondet e vendeve anëtare të BE-së; dhe
- 9.5 Bashkëpunimi me donatorët (Donacionet për ofrimin e ndihmës qoftë përmes mjeteve financiare, mbulimin e aktiviteteve ose organizimit të trajnimeve.

Në kuadër të TM1 ky objektiv ka pasur gjashtë (6) nën-aktivitete, nga të cilat dy (2) janë realizuar, dy (2) janë në proces të realizimit, ndërsa dy (2) të tjera kanë mbetur pa u realizuar. Nën-aktivitetet e pa realizuar janë të bëjnë më partnershipin me vendet tjera.

Objektiva 10 - Ngritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore si dhe edukimi i vazhdueshëm profesional

Në kuadër të këtij objektivi janë gjithsej tri (3) aktivitete si në vijim:

- 10.1 Zyrrat rajonale;
- 10.2 Rekrutimi i stafit (48 pozita) për plotësimin e pozitave të lira, të nevojshme për funksionalizimin e Institucionit; dhe
- 10.3 Ofrimi i trajnimeve për stafin e ri dhe stafin profesional.

Në kuadër të TM1 ky objektiv ka pasur katër (4) nën-aktivitete, nga të cilat dy (2) janë realizuar dhe dy (2) janë në proces të realizimit.

Objektiva 11 - Plotësimi i parakushteve për kontraktim të shërbimeve si dhe fillimin e mbledhjes së premieeve sipas ligjit Nr. 04/L -249 për Sigurimin Shëndetësor

Në kuadër të këtij objektivi janë gjithsej pesë (5) aktivitete si në vijim:

- 11.1 Krijimi i listës së shërbimeve të kujdesit shëndetësor themelor së bashku me deklaratën përkatëse financiare për vitin fiskal;
- 11.2 Krijimin e listës së shërbimeve të garantuara nga neni 7 i Ligjit për Sigurime Shëndetësore;
- 11.3 Përcaktimi i çmimeve për çdo shërbim të kujdesit shëndetësor për vitin fiskal;
- 11.4 Përcaktimi i bashkë-pagesave dhe niveleve tjera të bashkëfinancimit për kategoritë e liruara; dhe
- 11.5 Pajisja me kartela të sigurimit, ose mjet tjetër identifikimi për të siguruarit, përfshirë se paku 75% të të punësuarve në sektorin publik dhe privat, si dhe 75% të individëve të kategorive të liruara.

Në kuadër të TM1 ky objektivi ka pasur pesë (5) nën-aktivitete, nga të cilat një (1) është realizuar, një (1) është në proces të realizimit, ndërsa tri (3) kanë mbetur të pa realizuara. Aktivitetet e pa realizuara kanë të bëjnë me aktet nën-ligjore për ofrimin e shërbimeve shëndetësore.

Objektiva 12 - Përgatitja dhe finalizimi i listës së barnave jashtë-spitalore (më çmime) të cilat do të paguhën nga Fondi

Në kuadër të këtij objektivi janë gjithsej katër (4) aktivitete si në vijim:

- 12.1 Inicimi i procedurës për krijimin e bazës ligjore për kontraktimin e barnatoreve;
- 12.2 Finalizimi i listës së barnave jashtë-spitalore më çmime, të cilat do të paguhën nga Fondi;
- 12.3 Lidhja e marrëveshjeve të mirëkuptimit me komuna për përdorimin e E-recetës nga QKMF-të; dhe
- 12.4 Lidhja e kontratave më barnatoret për barnat të cilat do të paguhën nga Fondi.

Në kuadër të TM1 ky objektivi nuk kishte nën-aktivitete, shtyrja e planifikimit të tyre është bërë për shkak të pengesave ligjore që janë hasur në lidhje me kontraktimin e barnatoreve dhe realizimi është shtyrë derisa nuk qartësohet korniza ligjore.

Objektiva 13 - Njoftimi i publikut përmes kampanjave informuese dhe rritja e besimit nga ana e publikut

Në kuadër të këtij objektivi janë gjithsej tri (3) aktivitete si në vijim:

- 13.1 Analizë mbi nevojat e informimit, përfshirë grupet e targetuara, metodologjinë e përdorur, etj;
- 13.2 Përgatitja e materialeve të nevojshme (broshurave, seminareve, spoteve, njoftimeve në faqen elektronike, etj); dhe
- 13.3 Organizimi i kampanjave informuese.

Në kuadër të TM1 ky objektiv ka pasur gjashtë (6) nën- aktivitete, por që asnjë nga këto nuk janë realizuar për shkak të mungesës së kuadrit profesional në kuadër të Fondit i cili/e cila do të mbikëqyrte realizmin e këtij objektivi.

Objektiva 14 - Sigurimi i lokacionit/fillimi i ndërtimit të objektit të Fondit për Sigurime Shëndetësore

Në kuadër të këtij objektivi janë gjithsej tri (3) aktivitete si në vijim:

- 14.1 Caktimi i parcelës, përgatitja e projektit ideor si dhe marrja e lejes së ndërtimit;
- 14.2 Procedurat e tenderimit dhe lidhja e kontratës; dhe
- 14.3 Fillimi i ndërtimit të objektit.


Në kuadër të TM1 ky objektiv ka pasur dy (2) nën-aktivitete, të cilat janë realizuar në pajtueshmëri me planifikimin e tyre.

RAPORT TREMUJOR - TM1/2019

Tabela nr. 8. Rezultatet e arritura në raport me objektivat e përcaktuara për periudhën tremujore TM-1

Objektivat	Numri i nën-aktiviteteve të planifikuara për 2019	Numri i nën-aktiviteteve të planifikuara për TM-1	Numri i nën-aktiviteteve të realizuara në TM-1	Numri i nën-aktiviteteve të pa realizuara në TM-1	Shkalla e realizimit të planit të punës 2019 në TM-1
Objektiva 1 - Sigurimi i një qeverisje efektive, transparenca dhe llogaridhënia në FSSH.	26	22	22	0	100.00%
Objektiva 2 - Përgatitja e planit strategjik pesë (5) vjeçar dhe planit vjetor të punës për vitin 2020.	5	2	2	0	100.00%
Objektiva 3 - Identifikimi i nevojave për plotësim /ndryshimin e akteve ligjore dhe nënligjore si dhe procedurave të brendshme administrative si dhe inicimi i tyre për kompletimin e legjislacionit.	19	7	7	0	100.00%
Objektiva 4 - Zhvillimi dhe implementimi i sistemeve.	19	18	18	0	100.00%
Objektiva 5 - Implementimi i SIF-it.	24	4	3	1	75.00%
Objektiva 6 - Bashkëpunimi me Shërbimin Spitalor Klinik Universitar të Kosovës (SHSKUK) (KPSH) dhe Institucionet tjera të kujdesit shëndetësor. Parapërgatitja për kontraktimin e shërbimeve shëndetësore.	5	1	1	0	100.00%
Objektiva 7 - Propozimi i Skemës së Financimit të Sektorit të Shëndetësisë.	7	7	3	4	42.86%
Objektiva 8 - Menaxhimi efikas i trajtimeve mjekësore jashtë Institucioneve Publike Shëndetësore.	4	4	4	0	100.00%
Objektiva 9 - Ngritja e bashkëpunimit me Institucionet tjera vendore si dhe me partneret ndërkombëtar.	13	6	4	2	66.67%
Objektiva 10 - Ngritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore si dhe edukimi i vazhdueshëm profesional.	6	4	4	0	100.00%
Objektiva 11 - Plotësimi i parakushteve për kontraktim të shërbimeve si dhe fillimin e mbledhjes së premiumeve sipas ligjit Nr. 04/L -249 për Sigurimin Shëndetësor.	21	5	2	3	40.00%
Objektiva 12 - Përgatitja dhe finalizimi i listës së barnave jashtëspitalore (më çmime) të cilat do të paguhen nga FSSH.	6	0	0	0	0.00%
Objektiva 13 - Njoftimi i publikut përmes kampanjave informuese dhe rritja e besimit nga ana e publikut.	9	6	0	6	0.00%
Objektiva 14 - Sigurimi i lokacionit/fillimi i ndërtimit të objektit të Fondit për Sigurime Shëndetësore.	6	2	2	0	100.00%
Gjithsej	170	88	72	16	81.82%

Figura nr. 4. Rezultatet e arritura në raport me objektivat e përcaktuara (nën-aktivitetet) për periudhën tremujore TM-1



Nga figura me lartë shohim se shumica e objektivave (nën-aktivitetet për TM-1) janë përmbushur gjatë periudhës tremujore TM-1 2019. Në total realizimi i objektivave arrin në 82%. Nga 14 objektivat e përcaktuara në 11 prej tyre realizimi ishte i plotë ose i kënaqshëm, ndërsa në tri (3) objektiva niveli i realizimit ishte më i ulët. Realizimi më i ulët ishte te:

1. **Objektiva 7** – Propozimi i Skemës së Financimit të Sektorit të Shëndetësisë. Lidhur me këtë objektivë është bërë një draft analizë për financimin e sektorit të shëndetësisë nga konsulenti i Bankës Botërore, mirëpo kjo analizë do të zgjerohet edhe me shumë në dokumentin e cili do të finalizohet në fund të muajit maj 2019;
2. **Objektiva 11** - Plotësimi i parakushteve për kontraktim të shërbimeve si dhe fillimin e mbledhjes së premiumeve sipas ligjit Nr. 04/L -249 për Sigurimin Shëndetësor; dhe
3. **Objektiva 13** - Njoftimi i publikut përmes kampanjave informuese dhe rritja e besimit nga ana e publikut.

Arsyet e mos përmbushjes së objektivave të lartcekura ndërlidhën me disa faktor, si:

1. Vonesat në aprovimin e planit vjetor të punës për vitin 2019;
2. Vonesat në plotësim/ndryshimin e legjislacionit për sigurimin shëndetësor; dhe
3. Mos plotësimi i pozitës së zyrtarit për komunikim (objektiva 13 në kuadër të së cilës nuk janë plotësuar asnjëri nga nën-aktivitetet e përcaktuara.

Megjithatë duke marrë parasysh të gjithë faktorët, realizimi i planit në 82% tregon performancë të kënaqshme për këtë periudhë.

5 Shtojca - Objektivat dhe aktivitetet e realizuara në TM1 – 2019

Objektivat	Aktivitetet	Nën-aktivitetet	Nën-aktivitete të përfunduara	Nën-aktivitete në proces	Nën-aktivitete të pa përfunduara
Objektiva 1 - Sigurimi i një qeverisje efektive, transparencë dhe llogaridhënia në FSSH.	1.1. Përgatitja e një regjistri të rreziqeve të mundshme si dhe menaxhimi i efektiv i tyre.	1.1.1. Krijimi i grupit punës për identifikimin e rreziqeve.	X		
		1.1.2. Hartimi i regjistrit të rreziqeve.	X		
		1.1.3. Caktimi i personit përgjegjës për raportim dhe monitorim të regjistrit.	X		
		1.1.4. Monitorimi i rregullt i regjistrit të rreziqeve.	X		
	1.2. Menaxhimi efikas i buxhetit në përputhje me ndarjet buxhetore për vitin 2019.	1.2.1. Hartimi i planit të rrjedhjes së parasë.	X		
		1.2.2. Lista e obligimeve nga viti paraprak.	X		
		1.2.3. Hartimi i specifikave për Investimet kapitale.		X	
		1.2.4. Raportimi i rregullt mujor mbi shpenzimet konform planit të rrjedhjes së parasë.	X		
	1.3.2. Planifikimi dhe përfundimi i auditimeve të brendshme (katër auditime) bazuar në fushat e identifikuar me rrezik.			X	
		1.3.6. Përcjellja e zbatimit të rekomandimeve të auditimit të brendshëm.		X	
	1.4. Menaxhimi efikas dhe raportimi i drejtë dhe i saktë i obligimeve të papaguara.	1.4.1. Raportimi i rregullt mujor mbi obligimet e papaguara.	X		
		1.4.2. Mbajtja e një regjistri mbi detyrimet kontingjente.	X		
	1.5. Menaxhimi efikas dhe raportimi i drejtë dhe i saktë i pasurisë jo-financiare.	1.5.1. Krijimi i komisionit për inventarizimin e pasurisë.	X		
		1.5.2. Hartimi i regjistrimit të inventarizimit të pasurisë.		X	
		1.5.3. Krijimi i komisionit për transferin e pasurisë nga MSH në Fond.	X		
		1.5.4. Transferi i pasurisë nga MSH në Fond.	X		
		1.5.5. Evidentimi i rregullt i pasurisë së re (pranuar/blejë).	X		
	1.6. Hartimi i Pasqyrave Financiare Vjetore.	1.6.1. Grumbullimi i të dhënave financiare.	X		
		1.6.2. Hartimi i pasqyrave financiare vjetore.	X		
	1.7. Raporti Vjetor për vitin 2018.	1.7.1. Krijimi i grupit punës për hartimin e raportit vjetor.	X		
		1.7.2. Krijimi i modelit të raportimit vjetor.	X		
		1.7.3. Hartimi i raportit vjetor për vitin 2018.	X		

Objektiva 2 - Përgatitja e planit strategjik pesë (5) vjeçar dhe planit vjetor të punës për vitin	2.1. Përgatitja e planit strategjik pesë (5) vjeçar duke përfshirë vizionin, misionin, vlerat dhe qëllimet strategjike.	2.1.1. Procedurat administrative si dhe aprovimi i llogos së Fondit		X	
		2.1.2. Krijimi i grupit punës për hartimin e planit strategjik.		X	
Objektiva 3 - Identifikimi i nevojave për plotësim /ndryshimin e akteve ligjore dhe nënligjore si dhe procedurave të brendshme administrative si dhe iniciimi i tyre për kompletimin e legjislacionit.	3.1. Dhënia e kontributit në plotësim/ndryshim të Legjislacionit ekzistues.	3.1.1. Dhënia e kontributit (përmes grupit punës) për draftin e Ligjit për Fondin për Sigurim Shëndetësor (eventualisht përfshirë pjesët që afektojnë Ligjin për Shëndetësi).		X	
		3.1.2. Iniciimi për plotësim/ndryshim të Rregullores për Menaxhim Financiar.	X		
	3.2. Nxjerrja e rregullores të reja të cilat janë të nevojshme për plotësimin e legjislacionit sekondar të Fondit për Sigurime Shëndetësore (FSSH).	3.2.1. Iniciimi për nxjerrjen e Rregullores së re për Sistematizimin e vendeve të punës në Fond.	X		
		3.2.2. Rregullorja për Vlerësimin e Stafit të Fondit.	X		
		3.2.3. Dhënia e kontributit në Aktin nënligjor për lirim nga pagesa e premiumit, bashkë-pagesave dhe detyrimeve tjera të bashkëfinancimit.	X		
		3.2.5. Iniciimi për nxjerrjen e Aktit nënligjor që rregullon statusin e të punësuarve në Fond.		X	
		3.2.11. Akte tjera të brendshme që sigurojnë veprimtarinë efikase të Fondit (arkivim, sigurinë, komunikimin publik, financa dhe buxhet, personel, etj).		X	
Objektiva 4 - Zhvillimi dhe implementimi i sistemeve.	4.2. Instalimi dhe konfigurimi i pajisjeve harduerike.	4.2.1. Huazimi i resurseve harduerike nga Agjencia e Shoqërisë së Informacionit (ASHI)	X		
		4.2.2. Regjistrimi i të gjitha pajisjeve harduerike në pronësi të FSSH-së	X		
		4.2.3. Përgatitja e specifikave teknike për blerje të laptopëve dhe pajisjeve tjera të TI-së me Bankën Botërore	X		
		4.2.4. Përgatitja e specifikave teknike për blerje të pajisjeve të TI-së.	X		
	4.3. Menaxhimi, përditësimi, mirëmbajtja dhe migrimi i serverëve dhe pajisjeve të tjera.	4.3.1. Menaxhimi i vazhdueshëm i serverëve, mirëmbajtja dhe migrimi i tyre (aktual + të rinj)		X	
		4.3.2. Instalimi, konfigurimi dhe futja në domen e kompjuterëve	X		
		4.3.3. Sigurimi i qasjes nga largësia për palët e ndërlidhura që përdorin rrjetin qeveritar		X	
		4.3.4. Përgatitja e specifikave teknike për implementimin e sistemit të sigurisë me skaner, për kontroll fizik të qasjes në objektin e FSSH-së.	X		
		4.3.5. Dizajnimi dhe standardizimi i formave elektronike për shkresa zyrtare të FSSH-së, krijimi i grupeve shpërndarëse të e-mailave zyrtarë për stafin e FSSH-së.		X	

	4.4. Planifikimi, zhvillimi dhe mirëmbajtja e sistemeve të brendshme të FSSH-së.	4.4.1. Krijimi i procedurave për llogaritë e shfrytëzuesve, politikat e sigurisë dhe procedurave tjera standarde të operimit për përdorimin, mirëmbajtjen dhe monitorimin e pajisjeve harduerike dhe softuerike.		X	
		4.4.2. Identifikimi dhe implementimi i arkivit digjital për ruajtje dhe menaxhim elektronik të dokumenteve.	X		
		4.4.3. Përmirësimi i sistemit për trajtime jashtë vendi.	X		
		4.4.4. Zhvillimi i sistemit për raportim të kostove dhe aktivitetit të shërbimeve shëndetësore (volumit) nga të gjitha nivelet e sistemit shëndetësor.	X		
		4.4.5. Planifikimi i sistemit për menaxhimin e burimeve njerëzore dhe paga.		X	
		4.4.6. Implementimi i sistemit për tavolinën ndihmëse.	X		
		4.4.7. Implementimi i sistemit të brendshëm për menaxhim të pasurive.		X	
		4.4.8. Analiza, planifikimi dhe skicikimi i ndërtimit të intranetit të FSSH-së.		X	
		4.4.9. Përgatitja e planit financiar, kapacitetet njerëzore, trajnime dhe teknologji në departamentin e MSI.	X		
Objektiva 5 - Implementimi i SIF-it.	5.1. Kontraktimi i SIF-it.	5.1.1. Caktimi i komisionit për vlerësimin e tenderit për SIF, pas kërkesës nga njësi PSHK/MSH.	X		
		5.1.2. Vlerësimi i ofertave për ofertuesit për implementimin e e-recetës.	X		
	5.2. Implementimi i E-recetës.	5.2.1. Përgatitja/Nënshkrimi i planit detal të projektit.		X	
	5.4. Implementimi i SIF-it (Moduli i ndërlidhjes me Agjencinë e Regjistrimit Civil (ARC), Bankën Qendrore të Kosovës (BQK), Administratën tatimore të Kosovës (ATK), si dhe institucionet tjera relevante.	5.4.1. Koordinimet me ARC, ATK dhe BQK, MSH, MPMS, ARBK dhe ASHI.			X

Objektiva 6 - Bashkëpunimi me Shërbimin Spitalor Klinik Universitar të Kosovës (SHSKUK) (KPSH) dhe Institucionet tjera të kujdesit shëndetësor. Parapërgatitja për kontraktimin e shërbimeve shëndetësore.	6.1. Finalizimi i procedurave për kontraktim dhe definimi modelit të kontratës për shërbime shëndetësore.	6.1.1. Shqyrtimi i modelit të kontratave për shërbime shëndetësore nga vendet e ndryshme.		X	
Objektiva 7 - Propozimi i Skemës së Financimit të Sektorit të Shëndetësisë.	7.1. Analiza e financimit të sektorit të shëndetësisë.	7.1.1. Krijimi i grupit punues brenda Fondit.	X		
		7.1.2. Shqyrtimi i kornizës ligjore dhe dokumentacionit tjetër të nevojshëm.	X		
		7.1.3. Vizita e vendeve të regjionit për shqyrtimin e përvojave të tyre në këto procese.			X
	7.2. Finalizimi i Plan-Propozimit të Skemës së Financimit të Sektorit të Shëndetësisë.	7.2.1. Draftimi i parë i plan propozimit të skemës.	X		
		7.2.2. Diskutimi i plan-propozimit me palët e interesit.			X
		7.2.3. Inkorporimi i komenteve të dala nga diskutimet.			X
		7.2.4. Hartimi i draftit final të plan propozimit.			X
Objektiva 8 - Menaxhimi efikas i trajtimeve mjekësore jashtë Institucioneve Publike Shëndetësore.	8.1. Analiza e proceseve të trajtimit mjekësore jashtë Institucioneve Publike Shëndetësore.	8.1.1. Hartimi i raportit narrativ nga të dhënat e përmbledhura që nga viti 2006.	X		
		8.1.2. Raportimi periodik në Drejtorinë e SHSKUK-së lidhur me Raportet konsiliare për TMJISHP.	X		
	8.2. Barazimi me Institucionet Shëndetësore private (Brenda dhe jashtë vendit).	8.2.1. Rishikimi i procesit për trajtimet mjekësore jashtë Institucioneve Publike Shëndetësore.		X	
		8.2.2. Barazimet me spitalet.		X	
Objektiva 9 - Ngritja e bashkëpunimit me Institucionet tjera vendore si dhe me partneret ndërkombëtar.	9.3. Lidhja e marrëveshjeve të mirëkuptimit me Institucionet e njëjta të vendeve të rajonit për shkëmbimin e përvojave.	9.3.1. Lidhja e marrëveshjeve të bashkëpunimit me Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor të Shqipërisë.			X
	9.4. Partnershipi me njërin nga Fondet e vendeve anëtare të BE-së.	9.4.1. Përcaktimi i fushave të cilat janë të nevojshme për përmirësim të mëtejme.			X
		9.4.2. Analizë e Fondeve Shëndetësore të vendeve të BE-së të cilat mund t'i ofrojnë shërbimet e kërkuara.		X	
		9.4.3. Kontraktimi për partnership.		X	
	9.5. Bashkëpunimi me donatoret (Donacionet për ofrimin e ndihmës qoftë përmes mjeteve financiare, mbulimin e aktiviteteve ose organizimit të trajnimeve).	9.5.1. Takimi koordinuese me donatoret.	X		
		9.5.2. Identifikimi i aktiviteteve të përbashkëta.			

RAPORT TREMUJOR - TM1/2019

Objektiva 10 - Ngritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore si dhe edukimi i vazhdueshëm profesional.	10.2. Rekrutimi i stafit (48 pozita) për plotësimin e pozitave të lira, të nevojshme për funksionalizimin e Institucionit.	10.2.1. Rekrutimi i stafit për pozitat e lira bazuar në rregulloren për organizimin e brendshëm.				
	10.3. Ofrimi i trajnimeve për stafin e ri dhe stafin profesional.	10.3.1. Plani vjetor i trajnimeve.	X			
		10.3.2. Realizimi i trajnimeve bazike për stafin e ri.			X	
		10.3.3. Realizimi i trajnimeve për stafin profesional (trajnime të avancuara).	X			
Objektiva 11 - Plotësimi i parakushteve për kontraktim të shërbimeve si dhe fillimin e mbledhjes së premive sipas ligjit Nr. 04/L -249 për Sigurimin Shëndetësor.	11.1. Krijimi i listës së shërbimeve të kujdesit shëndetësor themelor së bashku me deklaratën përkatëse financiare për vitin fiskal.	11.1.1. Plotësim-ndryshimi i vendimit për themelimin e Komitetit Teknik (KT).	X			
		11.1.2. Rishikimi i Nomenklaturës së shërbimeve shëndetësore.				X
	11.3. Krijimi i listave negative për çdo shërbim të kujdesit shëndetësor për vitin fiskal.	11.3.1. Draftimi i listës së shërbimeve negative.				X
		11.4. Përcaktimi i bashkë-pagesave dhe niveleve tjera të bashkëfinancimit për kategoritë e liruara.	11.4.1. Marrja e përvojave nga vendet e rajonit.			
		11.4.2. Koordinimi me MPMS-në për testin e varfërisë.		X		
	Objektiva 13 - Njoftimi i publikut përmes kampanjave informuese dhe rritja e besimit nga ana e publikut.	13.1. Analizë mbi nevojat e informimit, përfshirë grupet e targetuara, metodologjinë e përdorur, etj.	13.1.1. Përcaktimi i grupeve të nevojshme për informim.			X
13.1.2. Përcaktimi i metodologjisë						X
13.2. Përgatitja e materialeve të nevojshme (broshurave, seminareve, spoteve, njoftimeve në faqen elektronike, etj).		13.2.1. Përgatitja e broshurave.				X
		13.2.2. Përgatitja e agjendave, materialeve për mbajtjen e konferencave dhe seminareve.				X
		13.2.3. Përgatitja e materialeve për informim nëpërmjet faqes elektronike.				X
13.3. Organizimi i kampanjave informuese		13.3.4. Themelimi dhe funksionalizimi i zyrës për këshilla dhe përkrahje të qytetarëve.				X
Objektiva 14 - Sigurimi i lokacionit/fillimi i ndërtimit të objektit të Fondit për Sigurime Shëndetësore.	14.1. Caktimi i parcelës, përgatitja e projektit ideor si dhe marrja e lejes së ndërtimit.	14.1.1. Procedurat administrative / Komunikimet / Kërkesat.	X			
		14.1.2. Analizë lidhur me parcelat të cilat mund të jenë në dispozicion dhe përcaktimi i parcelës me të përshatshme për zhvillimin e aktiviteteve të Fondit.				
Gjithsej			X			
			47	25	16	